

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Karburante ngjitur me pallatet/ Shpërthimi i "Eida" ngre alarmin: Sa të sigurt janë qytetarët dhe banesat p ranë tyre?
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/shperthimi-i-karburantit-eida-duhet-te-jete-alarm-duhet-t e-zhvendosen-i103191
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 09:43:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 09:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b1f1890dde8ed5270306f697ed24b2c67a02ae6e840e9ee436ae138d0470ecf05
TEKSTI	7752bbf700fe296c112cfaa2699cc6e8b7e49cbe325f4d627bea931669232bc1
PAMJA	8e12c16481e59f481dab798fc6fa3c79dfe7cfa66938f25b467be0183380bdf6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5c9f3ea6e03a8f27c9c0d03ec654916f76e9538ae6df15c84cae0bde4312d20b
E MËPARSHMJA	a54a6ae566cac5156f77e3142b5266edc07a3926eecd96fa0148872b181ca9ac
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/5c9f3ea6e03a8f27c9c0d03ec654916f76e9538ae6df15c84cae0bde4312d20b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKE
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

përleshje
mes policisë

me zotim
kundër
geverisë
Rama,

në Brazil
shkakton

mberjet e
medikamenteve
ve...

partnereve
të Elon

dhe, me
siguri,
edhe më

AKTUALITET

Karburante ngjitur me pallatet/ Shpërthimi i “Eida” ngre alarmin: Sa të sigurt janë qytetarët dhe banesat pranë tyre?

Nga Xhuljan Ferzaj Përditësimi i fundit 9 Shtator 2026, 11:21



Karburante ngjitur me pallatet/ Shpërthimi i “Eida” ngre

Shpërthimi i fuqishëm që tronditi mëngjesin e 9 shtatorit në një karburant në zonën e Bryllit në Tiranë, ku mbetën të plagosur tre punonjës dhe u shkakuan dëme të konsiderueshme materiale, rikthen në vëmendje një problem që prej vitesh shoqëron zhvillimin urban të kryeqytetit: praninë e pikave të karburantit dhe të impianteve të gazit pranë pallateve dhe zonave të banuara.

Ngjarja ndodhi në karburantin “Eida”, ku, sipas informacioneve paraprake të **Piranjat News**, shpërtheu një depozitë gazi në momentin kur një automjet po furnizohej. Shpërthimi ishte i fuqishëm dhe shkaktoi dëmtime të rënda në strukturën e objektit, ndërsa tre punonjës të karburantit u plagosën dhe u transportuan në spital. Sipas autoriteteve, ata janë jashtë rrezikut për jetën.

Përmasat e dëmeve bëhen të dukshme nga pamjet e siguruara në vendngjarje. Pjesë të strukturës së objektit u dëmtuan rëndë, ndërsa xhama, tulla dhe materiale të tjera u shpërndanë në zonën përreth. Banorët pranë karburantit tregojnë se shpërthimi u dëgjua në një distancë të konsiderueshme dhe shkaktoi dëme edhe në banesat përreth.

“Dëgjova një shpërthim shumë të fortë dhe u duk si tërmet. Karburanti është rreth 10 metra nga banesa ime. U thyen xhamat e dritareve dhe u zgjuam të gjithë të tronditur. Kur dolëm, pamë se ndërtesa e karburantit ishte dëmtuar dhe punonjësit ishin të shtrirë përtokë. Njoftuam policinë dhe ambulancën”, tregon një prej banorëve të zonës.

Fatmirësisht, pasojat e incidentit nuk u përshkallëzuan në një tragjedi më të madhe. Por fakti që një shpërthim i tillë ndodhi në një zonë të banuar, pranë pallateve dhe banesave, ngre pikëpyetje për sigurinë e këtyre aktiviteteve në një qytet me dendësi të lartë ndërtimi si Tirana.

Karburantet pranë pallateve, çfarë parashikojnë rregullat?

Vendosja dhe funksionimi i pikave të karburantit nuk është një çështje që mund të lihet vetëm në vullnetin e operatorëve. Legjislacioni shqiptar parashikon kërkesa për autorizimin, ndërtimin dhe funksionimin e këtyre aktiviteteve, si dhe respektimin e kushteve teknike dhe të sigurisë.

Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, përcakton rregullat për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe kërkon që subjektet të pajisen me autorizimet përkatëse dhe të respektojnë kërkesat e sigurisë.

Në të njëjtën kohë, rregullat për zonat e shërbimit në rrjetin rrugor përcaktojnë kriteret për distancat dhe kushtet e vendosjes së tyre, veçanërisht në raport me objektet ku qëndrojnë një numër i konsiderueshëm personash.

Kjo e bën të domosdoshëm një verifikim konkret të pikave të karburantit që ndodhen sot brenda zonave urbane: nëse kanë lejet përkatëse, nëse plotësojnë kushtet teknike, nëse respektojnë distancat e përcaktuara dhe nëse sistemet e sigurisë kontrollohen në mënyrë periodike.

Sa të sigurt janë pikat e karburantit në zonat e banuara?

Në Tiranë, pikat e karburantit gjenden në zona me ndërtime të dendura, pranë pallateve, bizneseve dhe rrugëve me qarkullim të lartë.

Prania e një karburanti pranë një banese nuk do të thotë automatikisht se subjekti është në shkëlqje të ligjit. Për këtë nevojitet verifikim individual i lejeve, distancave dhe kushteve teknike. Por pikërisht ky verifikim bëhet edhe më i rëndësishëm pas një incidenti si ai i mëngjesit të sotëm.

Një pikë karburanti nuk është një biznes i zakonshëm. Aty magazinohen dhe tregtohen materiale që, në rast të një defekti teknik, rrjedhjeje, zjarri apo shpërthimi, mund të shkaktojnë pasoja përtej hapësirës së vetë biznesit.

Dhe kur këto aktivitete ndodhen vetëm pak metra nga banesat, çdo incident mund të prekë drejtpërdrejt qytetarët që jetojnë përreth.

Shpërthimi i “Eida”, një alarm për institucionet

Ngjarja e sotme duhet të shërbejë si një moment për të rikthyer në vëmendje kontrollin e pikave të karburantit dhe veçanërisht të atyre që ndodhen pranë zonave të banuara.

Institucionet përgjegjëse duhet të kryejnë një verifikim të plotë të këtyre subjekteve, duke nisur nga dokumentacioni dhe lejet, deri te distancat, gjendja e depozitave të gazit, sistemet kundër zjarrit dhe kontrollet periodike të sigurisë.

Në rastet kur konstatohet shkelje e kushteve ligjore apo teknike, duhet të merren masat përkatëse, përfshirë edhe ndryshimin e mënyrës së funksionimit ose zhvendosjen e aktivitetit, nëse kjo kërkohet nga standardet e sigurisë.

Sepse pyetja që mbetet pas shpërthimit të Bryllit nuk lidhet vetëm me shkakun e incidentit. Ajo lidhet edhe me mënyrën se si qytetet menaxhojnë aktivitetet potencialisht të rrezikshme në një mjedis urban gjithnjë e më të dendur.

Sot pati tre të plagosur dhe dëme të mëdha materiale. Një incident i ngjashëm në rrethana të tjera mund të kishte pasoja shumë më të rënda.

Pikërisht për këtë arsye, shpërthimi i “Eida” duhet të shërbejë si një alarm për institucionet: siguria e banorëve që jetojnë pranë këtyre aktiviteteve duhet të jetë mbi çdo interes tjetër.**Piranjat News**



0:00

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 9 Shtator11:16

[Prokuroria kërkoi “arrest me burg”, gjykata liron Jozefin Markun dhe shoferin e tij](#)

Në kuadër të hetimit, Prokuroria po verifikon edhe përdorimin e simboleve të Policisë së Shtetit, ndërsa është e

AKTUALITET 9 Shtator10:47

[Shpërthimi tek “Eida” në Brryl, ISHTI: Dyshohet se zjarri nisi nga një automjet në karburant](#)

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ka bërë me dije se dyshohet që zjarri në pikën e karburantit të

AKTUALITET 9 Shtator10:40

[Banorët e Letanit në Elbasan protestojnë kundër ndotjes nga guroret: Na ka mbuluar pluhuri](#)

Banorët e fshatit Letan, në Njësinë Administrative Bradashesh të Bashkisë Elbasan, kanë protestuar këtë të m

AKTUALITET 9 Shtator10:30

[“Shpërthimi ndodhi brenda zyrave të karburantit”/ Drejtori i Zjarrfikëses Tiranë, Shkëlqim Goxhaj: Gazi dhe avujt e benzinës...](#)

Shpërthimi i një bombole gazi në një karburant në zonën e Bërrylit në Tiranë shkaktoi dëme të konsideru

AKTUALITET 9 Shtator10:27

[Prokuroria kërkon “arrest me burg”, nis seanca gjyqësore për Jozefin Markun](#)

Ka nisur në gjykatë seanca për caktimin e masës së sigurisë ndaj këngëtarit Jozefin Marku dhe shoferit të tij, Kr

AKTUALITET 9 Shtator10:22

[Situa ta me zjarret në vend/ Ministria e Mbrojtjes: 43 vatra të raportuara në 24 orë, 13 ende aktive](#)

Ministria e Mbrojtjes informon se gjatë 24 orëve të fundit (nga ora 09:00 e datës 8 shtator deri në orën 09:00 të datë

AKTUALITET 9 Shtator10:11

[Kreu i Shërbimit Zjarrfikës reagon për shpërthimin tek “Eida”: Dyshohet se ka ndodhur në zyrat e pikës së karburantit! Pati edhe rrjedhje gazi](#)

Shkëlqim Goxhaj, Drejtori i Shërbimit Zjarrfikës të Tiranës dha detaje në lidhje me shpërthimin e ndodhur mëngjesin e

AKTUALITET 9 Shtator09:58

[Prrenjasi kundër bashkimit me Librazhdin, banorët kundërshtojnë reformën territoriale: Vullneti i qytetarëve duhet të respektohet](#)

Këshilli Bashkiak i Prrenjasit ka nisur zyrtarisht turin e konsultimeve publike me qytetarët në kuadër të Reformës së re Ad

AKTUALITET 9 Shtator09:52

[Zbardhen dy vjedhje në Korçë, arrestohet 18-vjeçari dhe shpallet në kërkim bashkëpunëtori](#)

Policia e Korçës ka zbardhur dy raste vjedhjeje të ndodhura në qytet dhe ka arrestuar një prej autorëve të dyshuar, nd

AKTUALITET 9 Shtator09:37

[Shpërthimi tek karburant "Eida", ja si është gjendja e tre punonjësve](#)

Ministria e Shëndetësisë ka dhënë informacion të ri për gjendjen shëndetësore të tre personave të d

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 8 Shtator

[Bosi i drogës në kërkim nga SPAK filmoi në hote...](#)

Një figurë e krimit të organizuar, në kërkim nga SPAK për trafik droge, pastrim parash dhe organizatë kriminale, i niohur p

AKTUALITET 8 Shtator

[EMRAT/ U qëlluan me armë zjarri, kush janë dy t...](#)

Dy persona janë plagosur me armë zjarri mbremjen e sotme në zonën e Laprakës në Tiranë. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur ...

AKTUALITET 9 Shtator

[Tre punonjës të plagosur dhe një godinë e shemb...](#)

Një shpërthim i fuqishëm ka ndodhur mëngjesin e sotëm në karburantin “EiDA”, në zonën e Bërrylit në Tiranë.

INVESTIGIME 31 Maj 14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimeve...

video



Reagon Cllevio!



Reagon Cllevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënie të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin ne autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtën “shërim” me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënuar për” shpërdorim detyre” sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën“Durrës Marina” dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi



Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.